

Komuna e Hani i Elezit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Hanit të Elezit është krijuar në vitin 2005 si pilot njësi komunale për t'u shndërruar në komunë me kompetenca të plota që nga janari i vitit 2010.
2. Kjo komunë është e vetmja komunë në Kosovë e cila qeveriset nga një kandidat i pavarur. Kryetar i Komunës është Refki Suma. Nga gjithsej 15 ulëse sa ka Kuvendi i Hanit të Elezit, gjashtë janë nga LDK, tre janë nga AAK dhe gjashtë të tjerë nga PDK. Komuna e Hanit të Elezit, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ka 9.403 banorë.¹
3. Sipas hulumtimit të UNDP-së, Mozaiku i Kosovës 2012, 92% e banorëve të Hanit të Elezit janë të kënaqur me punën e Kryetarit të Komunës (në krahasim me mesataren e kosovarëve 69%); 86% janë të kënaqur me punën e Këshillit Komunal (në krahasim me mesataren e kosovarëve 63%); dhe 82% janë të kënaqur me punën e Administratës Komunale (në krahasim me mesataren e kosovarëve 64%).² Po sipas hulumtimit të UNDP-së, 83% e banorëve në Han të Elezit konsiderojnë se problemet e tyre mund të zgjidhen nga ana e komunës, përderisa vetëm 4% vlerësojnë se ato probleme mund të zgjidhen nga ana e nivelit qendror.³
4. Sipas një hulumtimi të Institutit GAP, në fund të vitit 2009, pesë problemet më të mëdha me të cilat përballeshin qytetarët e Hanit të Elezit ishin mungesa e ujësjellësit dhe kanalizimit, mungesa e infrastrukturës rrugore në zonat rurale, ndotja e lumit Lepenc, mungesa e hapësirave të gjelbëruara dhe mungesa e sinjalit të televizionit publik.⁴

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 58
Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216_825.pdf

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 58
Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216_825.pdf

⁴ Institutit GAP. Raporti komunal. Komuna e Hanit të Elezit. 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/68207_Hani%20i%20Elezit%20raporti%20komunal.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Hanit të Elezit

- 1. Mungesa e ujit të pijes.** Hani i Elezit e ka pasur të instaluar sistemin e ujësjellësit që nga vitet '80, i cili asokohe është instaluar për nevojat e fabrikës së “Sharr-Cem”. Edhe pas luftës ka pasur investime të reja në sistemin e ri të ujësjellësit, mirëpo problemi akoma nuk është i zgjidhur pasi që qytetarët ankohen për mungesë të ujit të pijes dhe reduktimeve të shpeshta (3 herë në ditë nga 2 orë furnizim me ujë të pijes). Ndërsa, shumica e fshatrave janë të organizuara me sisteme të ujësjellësit individual përmes puseve. Përveç kësaj, brengë më e madhe për qytetarët është edhe cilësia jo e mirë e ujit. Edhe në raportin e UNDP-së, është theksuar se cilësia e ujit të pijshëm nga ujësjellësi publik në Han të Elezit është shumë më e keqe në krahasim me mesataren e Kosovës. Gjashtëdhjetë e një përqind e familjeve të kësaj komune kanë pohuar se uji i çezmës është i turbullt nga papastërtia, 50% kanë thënë se shtypja e tij është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak, 43% se uji ka shije të keqe, kurse 45% kanë deklaruar se uji ka erë të keqe.⁵
- 2. Menaxhimi i mbeturinave.** Disa fshatra të Hanit të Elezit nuk janë nën menaxhimin e ndërmarrjes “Eko-higjiena” për mbledhjen e mbeturinave. Gjendja nga prezenca e mbeturinave dhe krijimi i deponive paraqitet më e keqe në fshatrat Gorancë, Krivenik dhe Rezhancë. Në hulumtimin e zhvilluar nga Qendra Regionale e Mjedisit (REC 2012), afro 43% e qytetarëve në këtë komunë nuk janë shprehur të kënaqur me menaxhimin e mbeturinave në vendbanimet e tyre.⁶ Gjithashtu problem tjetër qytetarët kanë edhe me mungesën e kanalizimit nëpër fshatra si në: Kremnikë, Gorancë dhe Paldenicë e epërme.
- 3. Ndotja e lumit “Lepenc”.** Ky lum i cili kalon nëpër Han të Elezit është i ndotur, ku përpos ndotjes nga derdhja e kanalizimeve dhe mbeturinave në të, lumi ndotet edhe nga hedhjet e kemikaleve si pasojë e ekzistencës së industrisë së rëndë në këtë komunë.

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 58
Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁶ Qendra Regionale per Mjedis. Raport hulumtimi mbi Planin e Veprimit per Mjedis. 2012. Fq 65.


- 4. Ndotja e ajrit.** Me gjithë përmirësimet në teknologjinë e fabrikës së çimentos “Sharr Cem,” akoma është evidente ndotja e ambientit në Hanë të Elezit. Gjatë vitit 2012, Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Kaçanik, pati paditur “Sharr Cem”-in për ndotje të mjedisit, procedurë kjo e iniciuar nga inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Qytetarët janë të brengosur edhe me mbetjen e mbeturinave nga prodhimet azbest çimentos të cilat mund të hasen përgjatë shtratit të lumit “Lepenc”. Sipas REC, afro 95% e qytetarëve në këtë komunë problem kryesor ambiental në komunën e tyre e kanë vlerësuar ndotjen e ajrit.⁷
- 5. Mungesa e çerdheve, stacionit të autobusëve dhe parkingjeve.** Janë këto tri kategori të ndryshme për të cilat qytetarët kanë shprehur shqetësimin e tyre. Edhe pse ndërtimi i çerdhes publike dhe stacionit të autobusëve janë paraparë në KAB 2014-2016, nevoja për to është më se e domosdoshme për qytetarët. Ndërsa mungesa e parkingjeve në qytet mbetet akoma problem i cili duhet të zgjidhet.
- 6. Mungesa e stafit mjekësor.** QKMF në Han të Elezit punon me 3 ndërrime në 24 orë, mirëpo ka mungesë të stafit mjekësor e sidomos të mjekut emergjent, pediatrit, gjinekologut dhe mjekut të dhëmbëve.
- 7. Mosmirëmbajtja e ndërtesave të vjetra.** Ndërtesat e vjetra dhe mos mirëmbajtja e tyre i japin një pamje jo të mirë qytetit të Hanit të Elezit. Komuna nuk e ka konsideruar deri më tani si prioritet imazhin e qytetit dhe kësaj nuk ka bërë ndonjë plan apo investim për gëlqerosjen e ndërtesave të vjetra. Në pamjen jo të mirë të qytetit ndikon edhe mungesa e parkingjeve të për vetura, mungesa e gjelbërimit, ndërtimeve të pa harmonizuara si dhe rrugëve të ngushta.

⁷ Regjionale për Mjedis. Raport hulumtimi mbi Planin e Veprimit për Mjedis. 2012. Fq 65.

Trendet Buxhetore në Komunën e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit ka planifikuar 1.8 milion euro buxhet në vitin 2013. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i kësaj komune është rritur për 403 mijë euro (28%). Të hyrat vetanake në vitin 2012 kanë qenë 231 mijë euro apo 16 mijë euro më shumë se në vitin 2010. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁸ ka gjetur se përveç tatimit në pronë, komuna nuk ka një regjistër të faturimit për llojet tjera të të ardhurave dhe listën e debitorëve.

Figure 1. Buxheti i Komunës së Hani të Elezit- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?hani-i-elezit/2013#/~ /hani-i-elezit>

Në bazë të grafikonit rreth trendeve të ndarjeve buxhetore shohim se investimet kapitale kanë pësuar një rënie prej 24 mijë euro (4%) në vitin

⁸ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Hanit të Elezit për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 07 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/Hani_i_Elezit_Report_SHOIP_600295.pdf

2012. Në vazhdim, në këtë vit ka pasur një ngritje tek shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve prej 80 mijë euro (45%).

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Komuna planifikon të ketë një ngritje graduale të buxhetit gjatë 2014-2016 që kryesisht do të financohet nga rritja e grantit qeveritar mirëpo edhe një ngritje të lehtë në të hyrat vetanake. Në anën tjetër, kjo ngritje do të shkoj kryesisht tek shpenzimet kapitale, pasi që të gjitha kategoritë tjera do të mbesin të pandryshuara gjatë vitit 2014-2016.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

Të hyrat Totale	2014	2015	2016
Të Hyrat Vetanake	1.874.695	1.924.931	1.964.679
Të hyrat vetanake	242.949	250.237	255.242
Grantet	1.631.746	1.674.694	1.709.437
Shpenzimet Totale	1.874.695	1.924.931	1.964.679
Pagat dhe Mëditjet	1.110.471	1.110.471	1.110.471
Mallrat dhe Shërbimet	183.353	183.353	183.353
Shpenzimet Komunale	36.922	36.922	36.922
Subvencionet dhe Transferet	37.000	37.000	37.000
Shpenzimet Kapitale	506.949	557.185	596.933

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulomtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Hanit të Elezit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.